

## **PËRDORIMI I SYZEVE DHE APARATEVE TË CAKTUARA GJATË DREJTIMIT TË MJETIT**

Përdorimi i syzeve, lenteve të kontaktit apo aparatura të tjera gjatë drejtimit të mjetit është i detyruar atëherë kur kjo tregohet në lejen e drejtimit, gjatë lëshimit apo rinovimit të saj me qëllim të plotësimit të defekteve të përcaktuara të shikimit.

Gjithashtu është e ndaluar për drejtuesin e mjetit gjatë lëvizjes përdorimi i aparaturave radiotelefonike apo i kufjeve, bëjnë përjashtim drejtuesit e mjeteve për transport njerëzish për llogari të të tretëve, por është i lejuar përdorimi i aparateve me zë të lartë që nuk kërkojnë përdorimin e duarve.